



01/Nr. 1615/2025

Bazuar në nenin 12 dhe 17 shkronja b të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, në nenin 11, paragrafi 1 nënparagrafin 1.12 dhe nenin 20 të Ligjit nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, dhe Udhëzimin Administrativ të MMPHI-se nr. 05/2014 për Përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikimin Hapësinor- nenin 4, 7,8, 10 dhe neni 12, si dhe Statutin e Komunës së Hani i Elezit neni 24 pika 1 dhe Udhëzimin Administrativ nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 20.03.2025 merr:

V E N D I M

Për

Shqyrtimin Publik të projektit "Plani Zhvillimor Komunal 2025 -2033"

Neni 1

Me këtë vendim shpallet në shqyrtim publik projekt "Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit 2025-2033".

Neni 2

2.1 Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi i projekt "Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit 2025-2033" bëhet në sallën e Qendrës Kulturore të Rinisë- Hani i Elezit së paku 8 (tete) dite pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2.2 Ekspozimi i projekt "Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit 2025-2033" bëhet në sallën e vjetër të Kuvendit të Komunës.

2.3 Për të gjitha prezantimet publike mbahen procesverbale.

2.4 Shqyrtimi publik i projektit "Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit 2025-2033" zgjatë 30 (tridhjetë) ditë sipas procedurave të caktuara me ligj.

2.5 Shpallja e shqyrtimit publik të projektit "Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit 2025-2033" bëhet së paku 8 (tetë) ditë para hapjes së tij përmes mjeteve të informimit publik, faqen zyrtare të komunës dhe në media televizive publike dhe lokale.

Neni 3

3.1 Në shqyrtimin Publik prezantohet pjesa tekstuale dhe grafike e Projektit "Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit 2025-2033".

3.2 Në Shqyrtimin Publik prezantohet fazat e Projektit "Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit 2025-2033" si;

- Informata mbi Kornizën Strategjike;
- Profili i Komunës,
- Vlerësimi i Gjendjes,
- Korniza e Zhvillimit Hapësinor si dhe
- Pjesa Hartografike.

3.3 Projekt “Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit 2025-2033” është i qasshëm për publikun në formë të shtypur dhe elektronike.

Neni 4

4.1 Projekt “Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit 2025-2033” i nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të publikut para se të finalizohet.

4.2 Të gjithë vërejtët , komentet, sugjerimet, që paraqiten nga publiku me gojë gjatë diskutimeve, me shkrim në librin e vërejtjeve apo përmes adresës elektronike, brenda afatit kohor të përcaktuar, përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik.

Neni 5

Shqyrtimi i projekt “Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit 2025-2033” organizohet nga komuna e Hani i Elezit në suaza të kompetencave të përcaktuar me ligj.

Neni 6

Me këtë vendim parashihet sigurimi i kushteve teknike dhe financiare që nevojiten gjatë kohës së shqyrtimit publik të projektit “Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit 2025-2033”.

Neni 7

Për zbatimin e këtij vendimi është autoriteti përgjegjës komunal për Planifikim Hapësinor.

Neni 8

Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 20.03.2025





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.1601/2025

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Udhëzimi Administrativ Nr.03/2014 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë neni 11 paragrafi 3, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit neni 57, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 20.03.2025 merr:

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
PËR VITIN 2024**

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024.
2. Duke ju referuar nenit (1) të këtij vendimi pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i punës për vitin 2024 i Komitetit për Komunitete.
3. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e Komitetit për Komunitete,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 20.03.2025





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 1990/2025

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 53, Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 53 pika 3, Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë neni 8, Statuti i Komunës neni 38, Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 45, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 20.03.2025 merr:

V E N D I M

PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NUMËR 01/Nr.9697 /2021

1. Kuvendi i komunës miratoi vendim për plotësim ndryshimin e vendimit me numër .01/Nr. 9697 /2021 për përbërjen e Komitetit për Komunitete në komunën e Hanit të Elezit.
2. Ndryshohet përbërja e Komitetit për Komunitete, z.Mefail Suma zëvendësohet me z.Sulejman Vila, ndërsa pjesa tjetër e vendimit mbetet e njëjtë.
3. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL, si dhe pas publikimit në webfaqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e Komitetit për Komunitete,
- Drejtorja për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data:20.03.2025

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta





01/ Nr.1991/2025

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 12, 40, 82.2, Ligji Nr.05L-031- për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 53, duke vepruar sipas Kërkesës së MPL-së Nr.116-2/25 të datës 31.01.2025, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 20.03.2025 merr:

V E N D I M
PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT ME NUMËR 01/ Nr. 9541/2024

1. Shfuqizohet Vendimi i Kuvendi të Komunës 01/Nr. 9541/2024 i datës 30.12.2024 për Ndërtesat e Vjetra Kolektive të cilat janë në Zonën Urbane.
2. Vendimi për shfuqizimin e vendimit të përcaktuar si në pikën 1 të këtij vendimi bëhet pas kërkesës së MPL-së të datës 31.01.2025 respektivisht konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës e cila pas shqyrtimit të vendimit të lartcekur konstatoi se: Duke u bazuar në Ligjin Nr.04/L-061 për Shitjen e Banesave për të cilat Ekziston e Drejta Banesore, e që me këtë ligj rregullohen kushtet dhe mënyra e shitjes së banesave në pronësi shoqërore dhe publike për të cilat ekziston e drejta banesore apo e drejta e shfrytëzimit me qira për kohë të pacaktuar, së bashku me pjesët e përbashkëta dhe pajisjet e ndërtesës si dhe mënyra e përcaktimit të çmimit të shitës të banesës dhe shuarja e së drejtës banesore. Në kapitullin e II-të është e Drejta e Banesës ku në nenin 7 thuhet se: “Çdo bartës i së drejtës banesore , përkatësisht shfrytëzues i banesës në pronësi shoqërore apo publike, përveç në raste nga neni 11 i këtij ligji, duhet të paraqes kërkesë me shkrim për blerjen e banesës “. Andaj, duhet saktë të dihet dhe dëshmohet se a është përfunduar procesi i shitblerjes së këtyre njësive banesore dhe shfrytëzuesit a janë tani pronarë të njësive banesore, pasi në përshkrimin e shkresës në disa vende përshkruhet që ende janë si shfrytëzues me të drejtë banesore e në disa vende përshkruhet se janë pronarë. Kjo duhet të qartësohet dhe dëshmohet nga Ligji Nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme. Gjithashtu, duke u bazuar në Ligjin Nr.04/L-134 për Ndërtesat e Banimi në Bashkëpronësi, në Kapitullin e III-të Krijimi Ndryshimi dhe Shuarja e Bashkëpronësisë, Neni 8 Krijimi i Bashkëpronësisë, fillimisht, fillimisht duhet të krijohet Bashkëpronësia në ndërtesat e vjetra. Andaj rishikoni se a janë ndjekur procedurat ligjore dhe vendimit t’i bashkëngjiten të gjitha dokumentet e kërkuara në bazë të ligjeve të lartcekura dhe pastaj të procedohet për miratim nga MMPH. Nga ajo që u tha më lartë, të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPH, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin e dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunës.

3. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 20. 03. 2025

